



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria -Vlada-Government**

Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit  
Ministarstvo Infrastrukture i Transporta  
Ministry of Infrastructure and Transport

Zv.Ministri i Ministrisë së Mjedisit Planifikimit, Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 145 (paragrafi 2), të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit nr. 06/L-113 për Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të pavarura, (Gazeta Zyrtare, Nr. 7/ 01 mars 2019), bazuar në dispozitat e nenit 7 (paragrafi 2) të Udhëzimit Administrativ Nr.06/2016 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 09/2013 për rrjetin e linjave dhe rendin e udhëtimit në transportin ndër urban të udhëtarëve me autobus dhe nenit 8 (paragrafi 3) të Rregullores nr. 14/2023 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenin 131 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenin 5 dhe 21 të Ligjit nr.04/L-179 për Transportin Rrugor, nenin 7 të Udhëzimit Administrativ 09/2013 për rrjetin e linjave dhe rendin e udhëtimit të transportit ndërurban të udhëtarëve me autobus dhe rekomandimit të komisionit profesional, nxjerr këtë:

**VENDIM**

**REFUZOHET** ankesa nr.8617 të datës 13.11.2023 parashtruar nga Unioni i shoqatës së operatorëve të transportit rrugor të udhëtarëve me autobus me seli në Prishtinë, kundër vendimit nr.8423 të datës 03.11.2023 mbi shpalljen e nisjeve të lira ndër-urbane nëpër regjione respektivisht nisjeve në relacionin: Prishtinë - Sllatinë - Prizren dhe ansajelltas si dhe nisjeve në relacionin: Prizren - Sllatinë - Prishtinë.

**ARSYETIM**

Komisioni i emëruar nga Ministri sipas vendimit nr.8973 datë 22.11.2023 pas shqyrtimit të ankesës, verifikimit të dokumentacionit dhe shkresave të tjera të lëndës dhe duke u bazuar në legjislacionin në fuqi respektivisht nenet 5 (paragrafi 4) dhe 7 të Udhëzimit Administrativ nr. 09/2013 mbi rrjetin e linjave dhe rendin e udhëtimit të transportit ndërurban të udhëtarëve me autobus, poashtu duke pasë parasyshë rrjetin aktual të linjave ndërurbane nisjet e shpallura në relacionin Prizren-Sllatinë-Prishtinë nëpër autoudhë nuk pengojnë në nisjet aktuale të lëshuara nga MMPHI-ja në relacionin aktual përgjatë magjistrales Prizren - Suharekë - Shtime - Prishtinë pasi që kjo është një trase e re.

Vlenë të theksohet fakti se kemi pasë kërkesa të shumta të qytetarëve për të pasur linja nëpër autoudhë për faktin e shfrytëzimit të infrastrukturës rrugore e cila ndikon në ngritjen e cilësisë së shërbimeve të transportit për udhëtarët përkatësisht komoditet dhe arritje më të shpejtë në kryeqytet, poashtu kjo domosdo ndikon edhe në koston financiare të shërbimeve si për pasagjerët një ashtu edhe për operatorët e transportit rrugor të udhëtarëve.

Gjithashtu duhet të kemi parasysh investimet e shumta që janë bërë në ndërtimin e infrastrukturës rrugore përkatësisht autoudhës e cila patjetër që duhet të shfrytëzohet në këtë kontekst, edhe shfrytëzimin e saj për bartjen e udhëtarëve në relacionet që përshkon autoudha gjegjësisht relacioni Prizren - Prishtinë dhe anasjelltas.

Në rastin konkret ka vlerësuar se është në interes të qytetarëve për të krijuar kushte sa më të favorshme në të mirë të ofrimit të shërbimeve të transportit rrugor të udhëtarëve me autobus të cilët në shumicën e rasteve për shkak të numrit të udhëtarëve që frekuentojnë në relacionin e lartëcekur nga magjistratja Prishtinë - Shtije - Prizren janë të obliguar që të qëndrojnë në këmbë për gjatë tërë udhëtimit.

Andaj në bazë të kësaj që u tha më lartë vendimi është marrë si në dispozitiv.

#### **Këshilla Juridike:**

Kundër këtij Vendimi pala e pa kënaqur mund të parashtrorjë padi në Gjykatën kompetente në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

#### **I dërgohet:**

- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Parashtruesit të ankesës;
- Departamentit të Transportit Tokësor;
- Arkivit të MI -së

